



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 18 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 18 të Rregullores QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2023, mori këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës, formohet Komisioni, në këtë përbërje;

- 1.z.Naim Çunaku, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës
- 2.z.Artrit Mulliqi, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës
- 3.z.Fatmir Rudari, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
4. z.Vigan Salihu, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
- 5.znj.Albina Llumnica, anëtare nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit sipas nenit 1 të këtij vendimi është 2 vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit të caktuar me këtë vendim.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot.01-016/01-0033581/23
Podujevë, datë; 15 maj 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha